

i FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

NITROFURANTOINE

Tableta - 100 mg
(Nitrofurantoinë)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efektëve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Nitrofurantoinë dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Nitrofurantoinë
3. Si ta merrni Nitrofurantoinë
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Nitrofurantoinë
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË NITROFURANTOINE DHE PËRSE PËRDORET

Nitrofurantoina është një antibakterial i cili bën pjesë në grupin e nitrofuraneve. Mekanizmi i veprimit të nitrofurantoinës ende nuk është sqaruar. Ka të dhëna se kjo lëndë frenon një varg sistemesh enzimatikë të baktereve dhe është vërtetuar se ajo ndërhyr në fazat e hershme të metabolizmit të karbohidrateve bakterore, duke frenuar acetilkoenzimën A. Nitrofurantoina vepron kundër një spektri të gjerë të mikrobeve të zakonshme patogjene të traktit urinar. Shumica e shtameve të *Escherichia coli* janë të ndjeshme; po ashtu, një pjesë e mirë e shtameve të *Klebsiella* – *Enterobacter* janë të ndjeshme ndaj nitrofurantoinës. Nitrofurantoinë indikohet në profilaksinë dhe mjekimin e infeksioneve akute ose rekurrencte e të pandërlikuara të rrugëve të poshtme urinare, si parësore apo edhe pas ndërhyrjeve kirurgjike. Nitrofurantoina indikohet veçanërisht për mjekimin e infeksioneve të shkaktuara nga shtame të ndjeshme të *Escherichia coli*, enterokokëve, stafilokokëve, *Citrobacter*, *Klebsiella* dhe *Enterobacter*. Shumica e shtameve të *Proteus* dhe *Serratia* janë rezistente. Të gjitha shtamet e *Pseudomonas* janë rezistente. Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Nitrofurantoinë për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë Nitrofurantoinë.

2. PËRPARA SE TË MERRNI NITROFURANTOINE

Mos merrni Nitrofurantoinë në qoftë se:

- keni mbindjeshmëri ndaj nitrofurantoinës, nitrofuraneve të tjera ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të këtij produkti;
- keni dëmtim të funksionit të veshkave, me klirensin e kreatininës më të vogël se 60 mL / min. ose me nivel të lartë të kreatininës në serum;

- keni porfiri akute;
- keni pamjaftueshmëri të glukozë-6-fosfat dehidrogenazës.

Nitrofurantoinë kundërinkohet në foshnjë nën 3 muaj, si edhe në gratë shtatzëna (në fund të shtatzënisë dhe gjatë lindjes) për shkak të mundësisë teorike të shfaqjes së anemisë hemolitike në fetus dhe në të porsalindurin, sepse sistemi enzimatik eritrocitar në ta është ende i pazhvilluar. Nitrofurantoinë nuk indikohet për mjekimin e abscesëve të kombinuara renale kortikale ose periferike.

Tregoni kujdes të veçantë me Nitrofurantoinë

Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se:

- keni efekte gastrointestinale (ato mund të minimizohen duke e marrë barin me ushqime ose qumësht, apo duke përshatur dozën);
- keni sëmundje të mushkërve;
- keni dëmtime të funksionit të mëlçisë;
- keni çrregullime neurologjike;
- keni diateza alergjike;
- vuani nga diabeti;
- vuani nga anemia;
- keni çrregullime të bilancit të elektrolitëve dhe pamjaftueshmëri të vitaminave të grupit B (veçanërisht acidit folik);
- keni predispozitë për të patur neuropati periferike;
- ju shfaqet këputje, zverdhje e lëkurës ose e syve, kuarje, rash në lëkurë, dhimbje kyçesh, diskomfort abdominal, të përziera, të vjella, humbje oreksi, urinë e errët, dhe feçe të zbehta ose gri. Mund të jenë shenja të një çrregullimi të mëlçisë.

Nitrofurantoinë mund të shkaktojë hemolizë në të sëmurët me pamjaftueshmëri të glukozë – 6 – fosfatdehidrogenazës. Gjatë përdorimit afatgjatë i sëmurit duhet mbikqyrur me kujdes për mundësinë e shfaqjes së simptomave hepatike, pulmonare ose neurologjike (sidomos të moshuarit). Nitrofurantoinë mund të shkaktojë reaksion fals pozitiv në analizat e urinës për glukozë. Urina mund të ngjyroset në të verdhë ose kafe për shkak të nitrofurantoinës.

Marrja e barnave të tjera

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Nitrofurantoinë.

Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Nitrofurantoinë në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit, sidomos këta të mëposhtmit:

- barnat antikolinergjike dhe ushqimet e rrisin përthithjen e nitrofurantoinës;
- kripërat e magnezit mund ta ulin përthithjen e kësaj lënde;
- probenecidi dhe sulfpirazoni mund të rrisin nivelet e nitrofurantoinës në serum, duke ulur jashtëqitjen e saj urinare;
- nitrofurantoina mund të antagonizojë efektin e acidit nalidiksik dhe kinoloneve;
- barnat që njihen për efektet e tyre hepatotoksike, hemolitike ose neurotoksike;

këto barna nuk duhen marrë njëkohësisht me Nitrofurantoinë.

Marrja e Nitrofurantoinë me ushqim dhe pije.

Tabletat Nitrofurantoinë mund të merren me ushqime dhe qumësht për të minimizuar efektet gastrointestinale dhe për të ndihmuar përthithjen.

Shtatzënia

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni të mbeteni shtatzënë. Nitrofurantoinë është e kundërinkuar të përdoret në shtatzëni (në fund të shtatzënisë dhe gjatë lindjes) për shkak të mundësisë teorike të shfaqjes së anemisë hemolitike në fetus dhe në të porsalindurin, sepse sistemi enzimatik eritrocitar në ta është ende i pazhvilluar.

Ushqyerja me gj

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjën me qumësht gjiri. Nitrofurantoinë duhet të shmangët gjatë ushqimit me gj.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Nitrofurantoinë mund të shkaktojë marrje mendsh dhe përgjumje. Në qoftë se vini re ndonjë prej këtyre efektëve, atëherë mos drejtoni automjetin dhe mos përdorni makineri.

3. SI TA MERRNI NITROFURANTOINE

Gjithmonë merreni Nitrofurantoinë sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Nitrofurantoinë janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj. Tabletat duhet të gëlltiten me të paktën gjysmë gotë ujë.

Në infeksionet akute e të pandërlikuara të traktit urinar: 50 mg, 4 herë në ditë, për 7 ditë.

Në infeksionet e rënda kronike rekurrencte: 100 mg, 4 herë në ditë, për 7 ditë. Në rastet e të përzierave të theksuara doza mund të ulët, por jo më pak se 200 mg në ditë. Në qoftë se të përzierat vazhdojnë, atëherë mjekimi duhet ndërprerë.

Në profilaksinë kirurgjike: 50 mg, 4 herë në ditë, para procedurës dhe 3 ditë më pas.

Fëmijët mbi 3 muajsh: Në infeksionet akute të traktit urinar, 3 mg/kg peshë në ditë, në 4 doza të ndara, për 7 ditë.

Mjeku juaj mund t'ju kërkohet të merrni Nitrofurantoinë për një kohë më të gjatë. Pyesni mjekun tuaj për këshillë në qoftë se nuk jeni të sigurt për sa kohë duhet ta merrni.

Në qoftë se keni marrë më shumë Nitrofurantoinë

Në qoftë se keni marrë më shumë Nitrofurantoinë se sasia që duhet të merrni, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se keni harruar të merrni Nitrofurantoinë

Në qoftë se harroni një dozë, merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj. Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar. Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efektëve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre. Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ndonjë prej efektëve anësore të mëposhtme ju shqetëson. Përdorimi për kohë të gjatë dhe me doza të larta mund të favorizojë këto efekte:

- reaksione gastrointestinale: anoreksi, të përziera, të vjella e diarre;
- marrje mendsh dhe përgjumje;
- reaksione akute e kronike pulmonare;
- neuropati periferike;
- janë konstatuar reaksione të mbindjeshmërisë (angioedema, urtikarie, ekzantema dhe kruarje); inflamacion i mureve të enëve të vogla të gjakut duke shkaktuar lezione në lëkurë (frekuencë e panjohur);
- më rrallë mund të shfaqen ikter kolestatik, hepatit, inflamacion i mëlçisë për shkak të sulmit që vetë sistemi imun i organizmit i bën qelizave të saj (frekuencë e panjohur), dermatit eksfoliativ, eritemë multiforme, pankreatit, artralgji, çrregullime në gjak (duke përfshirë agranulocitozën, trombocitopeninë dhe aneminë aplastike), inflamacion i indit të veshkës që rrethon tubujt, duke shkaktuar dëmtim të saj (frekuencë e panjohur), hipertension benign intrakranial dhe alopeci kalimtare.

Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI NITROFURANTOINE

Mbajeni larg fëmijëve. Mos e përdorni Nitrofurantoinë pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim. Mos e ruani mbi 25°C. Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe lagështia.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Nitrofurantoinë
Lënda aktive është nitrofurantoinë. Çdo tabletë përmban 100 mg nitrofurantoinë.
Lëndët ndihmëse janë: amidon, talk, stearat magnezit, povidon.

Përbajtja e paketimit

Kuti me 20 tableta.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:



PROFARMA sh.a.
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Shtator 2023.

SPECIFICATION



CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATTENTION, all the layers are visible.

If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.